



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 302

Datë: 15.06.2022

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 paragrafi 2 shkronja (d), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008", nenit 9 paragrafi 1 pika 7 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL, bazuar në nenin 10 dhe 19 të Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 datë:12.11.2008, si dhe kërkesës Nr.01/489 datë: 04.04.2022, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur, me datë: 13.06.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË
BASHKËSI PËR VITIN 2022

1. Miratohet Plani vjetor i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Malishevës për vitin 2022.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani vjetor i punës i KKSB-së për vitin 2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes organeve kompetente.
4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe plotësuar, me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në faqen zyrtare të Komunës së Malishevës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
MAPL-së.



PRANUAR ME: 09/09/2022
ACCEPTED ON:
PRIMJENO:
No. St. 01/489.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Nr. i Pr. _____ .
Datë: 25.03.2022 .

PËR:	z. Argjend THAQI, Kryesues i Kuvendit të Komunes
PËRMES:	z. Ekrem KASTRATI, Kryetar i Komunës.
NGA:	Halit MAZREKU, Koordinator i KKS-së.
LËNDA:	Kerkes , për miratimin e Projektpropozimit të Planit Vjetor të Punës së KKS-së për vitin 2022,-

I nderuar !

Bashkangjitur gjeni Projektpropozimin e Planit Vjetor të Punës së për vitin 2022, shqyrtuar, miratuar dhe rekomanduar nga anëtarët e KKS-së në takimin e mbajtur me date.2022, për miratim.

Me nderime !



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbështetur në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, nenin 9, paragrafi 1, pika 7, të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, Udhëzuesit për hartimin e PVP në kuadër të strategjisë Kombëtare për Siguri në Bashkësi, **n x j e r r :**

Projekt propozim:

PLANI VJETOR I PUNËS
së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
për vitin' 2022

Malishevë: Mars – 2022

PËRMBAJTJA:

Akronimet

1. Hyrje
2. Çka është KKSB-ja?
3. Themelimi dhe Përbërja,
4. Objektivat e KKSB-së,
5. Detyrat dhe përgjegjësitë e KKSB-së,
6. Të priturat e këtijë Plani të punës,
7. Të dhëna të përgjithshme për komunën e Malishevës.
8. Aktivitetet e planifikuara për vitin 2022,
9. Paraqitja grafike e Planit të Punës për vitin 2022.

Hyrje:

Ky Plan i Punës paraqet prioritetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2022, dhe jep përmbledhje të aktiviteteve të planifikuara për realizimin e synimeve të përcaktuara për vitin 2022. Po ashtu, i njëjti përcakton edhe treguesit e matshëm si dhe afatet kohore për kryerjen e secilit prej aktiviteteve dhe objektivave të parapara.

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës Nr. 02/32 të datës 28.01.2020 është themeluar KKSB, dhe përmes së cilave edhe janë përcaktuar: përbërja, objektivat, detyrat dhe përgjegjësitë dhe funksionimi i KKSB-së.

Gjithashtu, ky Plan i punës për vitin 2022 është mbështetur në Planin e Veprimit të Strategjisë për Siguri në Bashkësi dhe Strategjinë Nacionale për Siguri në Bashkësi të DSB – MPB.

Ky plan, pra do të shërbejë si bazë për funksionimin dhe organizimin e aktiviteteve të KKSB-së për vitin 2022.

A k r o n i m e t :

Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë plan të punës kanë këto kuptime:

Bashkësia – një grup etnik, fetar, gjuhësor, social, profesional, apo grupetjera që kanë karakteristika apo interesa të përbashkëta, perceptohen apo perceptojnë veten si të dallueshem në një menyrë në shoqërinë brenda së cilës ata ekzistojnë.

Siguria në Bashkësi – nënkupton, por nuk kufizohet në një koncept që vështron paraqitjen e ndryshimeve fizike dhe sociale në përputhje me prioritetet e bashkësive në mjediset lokale si një mënyrë për parandalimin e krimit dhe çrregullimeve tjera. Kjo iu lejon qytetarëve të përcjellin dhe të marrin përfitime të plotë nga jeta e tyre sociale dhe ekonomike pa frikë nga krimi, çrregullimet dhe fatkeqësitë.

Siguria Publike - nënkupton parandalimin dhe mbrojtjen nga ngjarjet që mund të kercenojnë sigurinë e publikut të përgjithshëm nga rreziku i konsiderueshëm, të tillë si krimi dhe fatkeqësitë, të dyja natyrore dhe atë të shkaktuar nga njeriu.

MPB - nënkupton Ministrinë e Punëve të Brendshme.

MAPL - nënkupton Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

DSB - Divizioni për Siguri në Bashkësi.

OJQ - nënkupton Organizatat joqeveritare të regjistruara në Zyrën për Regjistrim të OJQ-ve, pranë Ministrisë së Administratës Publike të Republikës së Kosovës.

KKSB – nënkupton Këshillin Komunal për Sigurinë në Bashkësi.

KLSP - nënkupton Këshillin Lokal për Siguri Publike, i themeluar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, si një organ këshillues, në kuadër të një zone të caktuar në çdo komunë që është në interesin më të mirë për një punë efektive të Policisë në bashkësi.

EVSB - nënkupton Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, që përbëhen nga zyrtarët komunal, policia dhe udhëheqësit e bashkësisë. Qëllimi primar i punës së tyre është që të identifikojnë dhe adresojnë çështjet mbi krimin, sigurinë dhe kualitetin jetësor.

Çka është KKSBJ-a?

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është trup konsultues për çështje të sigurisë me përfaqësim të gjerë të të gjitha bashkësive të një komune dhe përfaqësues të shoqërisë civile, siç është e përcaktuar në Nenin 7 të Ligjit për Policinë (Ligji Nr.03/L-035). KKSBJ-a është trup kryesor konsultues i komunës për çështjet e sigurisë, që në bashkëpunim me Policinë shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë për të gjitha bashkësitë në të mirë të të gjithë banorëve të komunës së Malishevës.

Themelimi dhe Përbërja

Themelimi dhe përbërja e KKSBJ-së në komunën e Malishevës është bërë në përputhje me Nenin 3, dhe 4, të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL.

Objektivat e KKSBJ-së

Këshilli komunal për Siguri në Bashkësi ka për qëllim:

Rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me dukuritë negative, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, identifikimin e brengave lidhur me sigurinë publike dhe rekomandimin e planeve të veprimit për t'i adresuar këto brenga në bashkëpunim me autoritetet komunale, komunitetet lokale dhe Policinë e Kosovës

Ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve përmes ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjedhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi.

Detyrat dhe përgjegjësitë

KKSBJ: si organ komunal këshillues për çështjet e sigurisë, e cila në bashkëpunim me policinë e Kosovës, analizonë dhe shqyrtonë të gjitha çështjet e sigurisë së komunitetit për të mirën e gjithë qytetarëve që jetojnë në komunën e Malishevës, me qëllimi të ngritjes së vetëdijes për lloje të ndryshme të dukurive negative, prishjes së rendit dhe sjelljeve të dhunshme brenda komunitetit lokal, si dhe identifikimi i shqetësimeve lokale sa i përket sigurisë publike, bazuar në Nenin 6, të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL

EVSBJ: janë grupe të ndryshme njerëzish që përfshijnë përfaqësues nga komuniteti, qeveritë lokale dhe policia, të cilët kanë për qëllim identifikimin dhe adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me krimin, sigurinë dhe kualitetin e jetës, për të arritur qëllimin e përbashkët, krijimin e një bashkësie më të sigurt. EVSBJ-të janë themeluar nga programi ICITAP/Departamenti i Drejtësisë së SHBA-ve, si dhe ndihmuar nga misioni i OSBE-së në Kosovë.

K L S P: kanë për detyrë implementimin e iniciativave të policimit në bashkësi duke mbledhur së bashku përfaqësues të komunitetit, policisë, shkollës, grave dhe rinisë, që të përmirësojnë sigurinë dhe kualitetin e jetës në bashkësinë ku ata veprojnë dhe jetojnë.

Të priturat e Planit të punës janë:

- Përfshirja e anëtarëve të shoqërisë civile në Këshillin komunal për siguri në bashkësi.
- Bashkëpunimi më i madh në mes të institucioneve lokale, shoqërisë civile dhe komuniteteve.
- Hartimi i planit të punës së institucioneve në bashkëpunim me shoqërinë civile për përmirësimin e sigurisë.
- Aprovimi i planit të punës nga Kuvendi i Komunës.
- Harmonizimi i aktiviteteve veprues i përbashkët i institucioneve dhe shoqërisë civile në sigurinë e të gjitha qytetarëve.

Aktivitetet e planifikuara për vitin 2022

Bazuar në Nenin 11, të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, KKSJ-ja, planifikon që gjatë vitit 2020 të mbajë së paku 6 (gjashtë) takime, në të cilat do të shjellohen qështjet e sigurisë publike të komunitetit si në vijim:

- Infrastruktura dhe mobiliteti, (Ndriçimi i rrugëve, Ndërtimi i Trotuarëve, e tj.),
- Ethet Hemoragjike KRIME- KONGO (masat e ndërmarra dhe parandalimin),
- Siguria në shkollat e mesme dhe fillore, (vendosja e videokamerave, themeliminimi i këshillave të nxënësve, etj),
- Vendosja dhe funksionalizimi videokamerave në qytezën e Malishevës **(Faza e dytë)**.
- Siguria e lëvizjes së nxënësve në trotuare. (shënjëzimi trotuarëve, zebrave etj.)
- Mbajtja dhe përdorimi i armëve ilegale dhe piroteknike, si dhe përdorimi i substancave narkotike.
- Qështjet e Ambijentit (identifikimi dhe largim i deponive të paligjshme).
- Masat e Parandalimit të prerjes ilegale të pyjeve.
- Masat e Parandalimit ndaj zjarreve në fusha dhe pyje.
- Largimi i lëmosh-kërkuesve nga rruga.
- Siguria e personave me aftësi të kufizuara. (qasja e PAK në Objekte, Ndërtimi i toaletit, etj).
- Bashkëpunimi me EVSB, KLSP dhe OJQ.
- Zgjidhja e problemit të kafshëve të braktisura, qentë endacakë. (Ndërtimi i shtëpisë së azilit për Kafshët e braktisura).


Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë për komunën e Malishevës

➤ Pozita gjeografike dhe karakteristikat e territorit të Komunës së Malishevës:

Komuna e Malishevës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, përkatësisht në pjesën lindore të Rrafshit të Dukagjinit. Territori i komunës përfshinë një sipërfaqe prej 306 Km² (2.8% të territorit të Kosovës), dhe shtrihet në një gjerësi gjeografike prej 42°28'41" dhe gjatësi gjeografike prej 20° 44'33". Kufizohet me komunat e Drenasit, Lipjanit, Suharekës, Rahovecit dhe Klinës.

Konfiguracioni i përshtatshëm i terrenit i mundëson komunës lidhje të mira të komunikacionit me të gjithë vendin. Me shumicën e qyteteve kryesore të Kosovës lidhet brenda një distance prej rreth 40-55 km - Gjakovë 40 km, Prizren 44 km, Prishtinë 49 km, Pejë 52 km, Ferizaj 56 km. Distancat më të mëdha janë me Mitrovicën -75 km, si dhe me Gjilanin - 80 km. Sa i përket lidhjeve ndërshtetërore, kalimi i autostradës Durrës-Merdarë përmes territorit të komunës e vë Malishevën në pozitë të volitshme. Kjo autostradë mundëson lidhje të lehtë dhe të shpejtë me Shqipërinë dhe portin e Durrësit, ndërsa planet për vazhdimin e mëtutjeshëm të kësaj autostrade, si dhe ndërtimi i autostradës së re për Han të Elezit do të mundësojnë lidhje cilësore me shtetet dhe korridoret rajonale të transportit.

Pozita e komunës së Malishevës ofron përparësi edhe sa i përket vlerës dhe burimeve natyrore. Hapësira komunale e cila kufizohet me terrenet kodrinore në pjesën lindore (në kufi me Drenasin, Lipjanin dhe Suharekën) dhe në Jug-perëndim (që në kufi me Rahovecin), si dhe shtrirja e sipërfaqeve të rrafshëta në qendër, ofrojnë një larmi të përmbajtjeve dhe potencialeve bujqësore, mjedisore dhe biodiversitetit.



➤ **Gjendja e resurseve ujore-lumore:**

Territori i komunës së Malishevës ka hidrografi relativisht të pasur.

Territorin e komunës së Malishevës e përshkon Pellgu i lumit **Mirusha**, cili buron në malet e Carralevës me lartësi mbidetare 795 m, dhe i cili prej burimit e deri në grykëderdhje, ka gjatësinë 29 km. Pellgu i lumit Mirusha është i rrethuar me Masivin Malor të Drenicës në lartësin mbidetare deri në 1057 m (Maja e Kasmaqit), Majen e Koznikut në lartësin mbidetare deri në 1006 m etj.

Lumi Mirusha, përbëhet prej 38 degëve (prrojeve) , të cilat pjesërisht ose tërësisht thahen (shterren) deri në periudhat me lagështi.

Malet dhe Bjeshkët në Komunën e Malishevës:

Pyjet në komunën e Malishevës, mbulojnë sipërfaqen prej 13750 hektarë, ose 45% të sipërfaqes së komunës, prej së cilës :

- sektorit shoqëror , i takojnë 7700 ha;
- sektorit privat, i takojnë6050 ha.

Fondi i pyjeve, në territorin e komunës së Malishevës, sipas origjinës, karakterizohet

➤ **Klima :**

Në territorin e komunës së Malishevës dominon klima e mesme kontinentale që karakterizohet me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë.

Muajt më të nxehtë janë korriku dhe gushti me temperaturë maksimale 24.6°C , ndërsa muaji më i ftohtë është janari me temperaturë minimale -10°C .

Reshjet mesatare gjatë vitit janë 755.5 mm, reshjet minimale 511 mm, ndërsa reshjet maksimale 1108 mm.

➤ **Numri i popullsisë:**

Sipas regjistrimit të vitit 2011, aktualisht, Komuna e Malishevës numëron rrethë 70.000 banorë, prej tyre rreth 55.000 janë rezident, dhe rrethë 15.000 persona që jetojnë jashtë vendit-jorezident. *(prej numrit të përgjithshëm të banorëve, llogaritet se 850 prej tyre janë me aftësi të kufizuara).*

Në qytetën e Malishevës si qender Komunale dhe Administrative jetojnë rreth 3.500 banorë, kurse pjesa tjetër jetonë nëpër 43 vendbanime tjera.

Dendësia e popullsisë është 178.4 banorë për km², që është pothuaj se e njëjtë me nivelin e Kosovës - 177.4 banorë për km².

➤ **Mosha dhe gjinia:**

Në bazë të regjistrimit të fundit, popullsia e komunës është kryesisht e re. Vërehet një dominim i grupmoshave nën 20 vjet (45%). Popullsia aktive 15-64 vjet përfshinë 62% të banorëve të komunës.

Sa i përket raportit gjinor në përbërjen e popullsisë, në Komunën e Malishevës vërehet një dominim i vogël i femrave prej rreth 6%, ku 47% janë meshkuj (27.563) dhe 53% femra (30.702).

➤ **Përkatësia etnike:**

Struktura nacionale e popullsisë është 99.8% shqiptar, 0.2 të tjerë.

Pjesëtarë të komunitetit rom janë 70 banorë (0,13%), të komunitetit ashkali 14 banorë (0.03%), ndërsa 18 banorë (0,03%) janë të tjerë apo të padeklaruar.

➤ **Ekonomitë familjare:**

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë komuna e Malishevës ka 6,878 ekonomi familjare me madhësinë mesatare të familjes prej 7.93 persona. Komuna e Malishevës në krahasim me komunat fqinje dhe në nivel të Kosovës është një nga komunat me familje të mëdha, ku 53% e ekonomive familjare kanë më shumë se 7 anëtarë të familjes.

➤ **Vendëbanimet e komunës së Malishevës sipas Statutit të komunës së Malishevës janë:**

Astrazupi, Balinca, Banja, Bellanica, Bubaveci, Bubli, Burimi, Berisha, Carralluka, Malisheva, Maralia, Maxharra, Mirusha, Mleqani, Lladrovci, Lladroviqi, Llapçeva, Llazica, Lubizhda, Drenoci, Pagarusha, Panorci, Pllaqica, Seniku, Shkarashniku, Shkoza, Gurbardhi, Temeqina, Dragobili, Rudi, Qypeva, Gajraku, Jançishti, Tërpeza e Poshtme, Gurishta, Kijeva, Tërpeza, Vërmica, Damaneku, Turjaka, Ngucati, Fshati i Ri, Gollubovci, Kërvasaria.

➤ **Punësimi:**

Sipas vlerësimeve aktuale, në popullsinë aktive në komunë përfshihen gjithsej 10168 persona, që përbën 28% të popullsisë së aftë për punë. Prej këtij numri të popullsisë aktive, 2943 (29%) janë të punësuar, ndërsa 7225 (71%) janë të papunësuar.

➤ **Vlerat e Trashëgimis Kulturore**

Në komunën e Malishevës ekzistojnë potenciale të rëndësishme të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale. Në shumëllojshmërinë e vet kjo trashëgimi kulturore përfshinë objekte të trashëgimisë arkitekturale, arkeologjike, peizazh kulturor dhe një zonë të veçantë të mbrojtur. Numri i objekteve dhe tërësive të trashëgimisë kulturore në Malishevë është 67.

➤ **Furnizimi me ujë:**

Edhe pse shumica e fshatrave (vendbanimeve), të komunës së Malishevës, burimin e ujit e kanë brenda ose në afërsi të fshatit, furnizimin me ujë përmes ujësjellësit (në mënyrë të organizuar) e kanë të rregulluar disa fshatra. Përveq sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatin Kijevë, Mirushë, Bellanicë, Lubizhdë dhe në qytezë të Malishevës, të ndërtuara pas lufte, asnjë vendbanim tjetër nuk posedon sistem të kanalizimit.

Derdhja e ujërave të zeza bëhet drejtpërdrejt (pa u trajtuar), në lumenjë dhe ujëra sipërfaqësor.

➤ **Kanalizimi:**

Rrjeti i kanalizimeve në Malishevë është duke u zhvilluar. Deri tani 22 vendbanime (50%) janë të lidhura në rrjetin e kanalizimit, duke përfshirë Malishevën. Tetë vendbanime (18%) kanë lidhje të pjesshme në rrjet të kanalizimit, ndërsa 14 vendbanime nuk kanë lidhje fare. Shkarkimi i ujërave të zeza në lagjet pa lidhje në rrjet bëhet përmes gropave septike ose në formë tjetër, kryesisht të papërshtatshme në aspekt mjedisor.

➤ **Ndotja e mjedisit:**

Në komunën e Malishevës, edhe pse nuk ka asnjë objekt industrial, ndotja e ambientit vërehet në masë të madhe.

Si një nga komunat më e pazhvilluara në vend, Malisheva ka një mjedis relativisht të pastër, por ajo është larg nga të qenit jo e ndotur. Kontaminimi i tokës dhe ujit, me mbetjet e ngurta dhe ujërat e zeza, guroret, degradimi i pyjeve, humbja e tokës bujqësore përmes ndërtimit të paligjshëm janë kërcënime aktuale nëpër tërë territorin e komunës.

Malisheva është njëra nga komunat, në të cilën shfaqën epidemit e ndryshme.

➤ **Bujqësia:**

Pasi që komuna e Malishevës, ekonomikisht është ndër komunat më të pazhvilluara të Kosovës, popullata e kësaj ane, për ta siguruar ekzistencën e tyre, janë të detyruar që të mbështeten në aktivitete bujqësore. Vlerësohet, se afro 70% - 80%, e familjeve mbështeten në aktivitete bujqësore.

Bujqësia në komunën e Malishevës, ende është ekstenzive, ka shkallë të ulët të zhvillimit, dhe është joprofitabile.

Nga sipërfaqja e përgjithshme prej 30.586 hektarë, tokë e punueshme bujqësore është sipërfaqja prej 11.735 hektarë, ose 38% e asaj sipërfaqe. Kjo sipërfaqe shfrytëzohet kryesisht për kultivimin e drithrave, perimkulturave dhe të disa bimëve furagjere.

Sektorit shoqëror i takon sipërfaqja prej 4200 hektarë, prej të cilave 2558 ha, është tokë e punueshme bujqësore.

Kjo sipërfaqe e sektorit shoqëror shfrytëzohet për kultivimin e hardhis së rrushit, pemishteve, dhe të drithrave

Nga kulturat lavërtare që kultivohen në këtë regjion, janë : gruri, misri, thekra, elbi tërshëra etj.

Nga kulturat tjera që kultivohen , janë: hardhia e rrushit, llojet e ndryshme të pemëve, perimet, dhe disa bimë furagjere.

Prodhimet bujqësore më tepër janë të dedikuara në plotësimin e nevojave vetanake të familjeve bujqësore, e fare pak për treg.

➤ **Ekonomia:**

Komuna e Malishevës , në aspektin e zhvillimit ekonomik, përfshihet në radhën e komunave më të pa

zhvilluara të Kosovës.

Në komunën e Malishevës, nuk është trashëguar kurrfarë industrie nga periudha e paraluftës.

Potencialet për zhvillim ekonomik nuk janë shfrytëzuar plotësisht deri më tani, ndërsa Malisheva i takon komunave më të pazhvilluara të Kosovës. Burimi kryesor i gjenerimit të të hyrave të qytetarëve të komunës së Malishevës janë prodhimtaria e vogël, bujqësia (ekonomitë familjare) dhe tregtia. Në përgjithësi, mjedisi për zhvillimin e ndërmarrjeve ende mbetet i pafavorshëm dhe me mbështetje të pamjaftueshme

➤ **Strehimore:**

Në komunën e Malishevës nuk ka strehimore të posaçme për raste emergjente. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, ka paraparë këto objekte të përkohëshme për strehim në raste emergjente,.

“Mvarësisht prej Situatave Emergjente, mund të shfrytëzohen edhe Objektet tjera Publike nëpër fshatra të territorit të komunës së Malishevës (shkollat, fushat e sportit, sallonet e Dasmave etj),”.

➤ **Institucionet Shëndetësore:**

Në Komunën e Malishevës Shërbimet shëndetësore publike kryhen në tri nivele: në shërbimin primar, shërbimin sekundar dhe në shërbimin tretësor.

Në Malishevë ka vetëm 1 mjekë për 2200 banorë,(vlerësim), që është për tre deri në katër herë më i ulët se standardet e shteteve në rajon.

Organizimi institucional i Mjekësisë Familjare është i organizuar me sa vijon:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare(QKMF) në Malishevë ofron shërbime shëndetësore 24 orë.

Qendrat e Mjekësisë Familjare(QMF) – ofrojnë shërbime shëndetësore gjatë ditëve të punës me orar të punës prej 07.00 – 15.00.

Ambullantat shëndetësore – ofrojnë shërbime shëndetësore gjatë ditëve të punës me orar të punës prj 07.00 0 15.00.

➤ **Institucionet edukativo arsimore dhe objektet shkollore:**

Në Komunën e Malishevës procesi edukativo arsimor zhvillohet, prej atij para fillor e deri të ai parauniversitar, dhe i cili menaxhohet nga Drejtoria e Arsimit të komunës së Malishevës.

➤ **Institucionet arsimore:**

- Procesi edukativo arsimor parashkollore me 1247 nxënës;
- 36 shkolla fillore me 5 paralele të ndara me 10243 nxënës;
- 3 shkolla të mesme (1-Gjimnaz dhe 2-Shkolla Profesionale) me 3200 nxënës;

Të gjitha objektet shkollore janë të ndertimit të ri, kryesisht të ndertuara pas luftës dhe të renovuara, dhe të cilat i plotësojnë kushtet për zhvillim normal të procesit edukativo arsimor.

➤ **Infrastruktura rrugore në Malishevë**

Shtrirja e rrjetit rrugor në territorin e Malishevës si dhe përmbajtja e të gjitha niveleve të hierarkisë rrugore kombëtare dhe komunale, mundësojnë lidhje të mira brenda Kosovës si dhe në nivel ndërkombëtar. Duke qenë një udhëkryq lokal regional, rruga magjistrale dhe ato regionale përballojnë trafik të ngarkuar apo mesatarisht të ngarkuar, që vërehet sidomos në qytetin e Malishevës, ku kryqëzohen rrugët regjionale.

Nr	Rruga	Gjatësia	Gjendja fizike	Ngarkesa
1	1)Segmenti i magjistrales M9 Kijevë-Balincë,	12 km	E mirë	Mes. e ngarkuar
2	2) Segmenti i regjionales Malishevë-Rahovec	9 km	E mirë	Mes. e ngarkuar
3	3) Segmenti i regjionales Malishevë-Orllat	10 km	E mirë	Mes. e ngarkuar
4	4) Segmenti i regjionales Malishevë-Kijevë	13 km	E dobët	Mes. e ngarkuar
5	5) Segmenti i regjionales Malishevë-Dule	8 km	E dobët	E ngarkuar

Shërbimi i transportit ofrohet në kuadër të sektorit publik dhe privat. Në kuadër të sektorit publik funksionon Njësia Punuese për Transport Publik "Kosovatrans" nga Prizreni. Përveç kësaj njësie, në mënyrë që të plotësohen kërkesat, janë në funksion autobusë dhe minibusë privat, si dhe shërbime të ndryshme të taksive.

➤ **Sistemi elektroenergjetik:**

Energjetika në kushtet bashkëkohore është një resurs i pazëvendësueshëm në kuptim të zhvillimit ekonomik, të ushtrimit të veprimtarive të tjera, të ngritjes dhe mbajtjes në nivel të standardit jetësor dhe të mirëqenies sociale në përgjithësi. Sot, sektori energjetikë nuk është në gjendje të bëjë një furnizim 24 orësh dhe bizneset e konsumatorët shtëpiakë ngarkohen me shpenzime shtesë duke përdorë gjeneratorë.

➤ **Rrjeti i shpërndarjes:**Sistemi i shpërndarjes në komunën e Malishevës funksionon në nivelet 10(20)kV, 10kV dhe 0.4kV.

Linjat e nivelit 10(20)kV arrijë gjatësinë totale prej 8.7km, ndërsa ato 10kV 78km. Linjat e nivelit 0.4kV janë ajrore arrijë gjatësinë totale 148km. Transformimi i tensionit për nivelin komunal

bëhet përmes tre transformatorëve 35/10 kV, ndërsa brenda nivelit komunal funksionojnë 196 transformatorë 10(20)/04 kV.

➤ **Telekomunikimi:**

Territori Komunës së Malishevës është tërësisht i mbuluar me rrjetin e telefonisë mobile të Valës 900 – 044-045, IPKO NET 049, kurse Qyteza e Malishevës, si qendër administrative e Komunës dhe Banja janë të mbuluara edhe me rrjetin e telefonisë fikse 029... të PTK-së, IPTV dhe Internet.

Territori i Komunës së Malishevës është i mbuluar mire me valet e Radio dhe TV shtetërore dhe lokale si dhe me radion lokale "Radio Malisheva", dhe të cilat mundësojnë alarmimin me kohë në Situata Emergjente.

Nuk ka të vendosura sirena për rast alarmi.

Nëpër disa fshatra mund të përdoren edhe autoparlantët e xhamiave për raste alarmi.

- **Telefonia:** Në territorin e Komunës së Malishevës veprojnë tre operatorë: Vala, Telekomunikacioni i Kosovës (TK) dhe IPKO të cilat ofrojnë telefoni fikse dhe internet brenda zonës urbane, si dhe në disa pjesë të zonave rurale (fshatra). TK - vepron në qendër dhe në dy fshatra të mëdha të komunës - Banjë dhe Kijevë, duke ofruar shërbime telefonike.

➤ **Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera që mund të ndodhin në territorin e Komunës së Malishevës:**

Territorin e Komunës së Malishevës, fatkeqësitë që mund të ndodhin janë:

- fatkeqësitë natyrore,
- fatkeqësitë e tekniko-teknologjike dhe,
- fatkeqësitë epidemiologjike dhe të tjera, të cilat mund të rrezikojnë jetën apo shëndetin e një numri të njerëzve dhe pasurinë dhe të shkaktojnë dëme materiale në shkallë të madhe.

Në Planin e Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga Fatkeqësit Natyrore dhe Fatkeqësit Tjera për Komunën e Malishevës, janë të identifikuar rreziqet me probabilitet me të lartë të ndodhjes janë nga:

Fatkeqësitë natyrore: vërshimet, thatësit, tërmetet, breshër, erëra të forta, bora dhe të tjera, si dhe epidemive dhe shpërthimet e sëmundjeve infektive dhe sëmundjeve të bimëve.

Fatkeqësi tekniko-teknologjike: zjarreve në objektet ku deponohen materiet e rrezikshme dhe zjarreve në objekte banimi dhe zjarre fushore dhe malore si dhe rrëshqitje e tokës për shkak të minierave dhe eksploatimi i resurseve minerale, aksidentet e komunikacionit e të tjera.

Fatkeqësitë epidemiologjike dhe të tjera, rrezikut nga (Etnet hemoragjike KRIME KONGO).

- **Zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera:**

Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera mund të përfshijnë, mvarësisht intensitetit, të vogël ose të madhë, një pjesë të territorit të komunës së Malishevës, ose edhe të gjitha fshatrat e komunës.

Vetë pozita gjeografike dhe komunikacioni rrugor i territorit të Komunës së Malishevës, mundëson ndarjen e territorit në 4 (katër) zona territoriale.

- **Pasojat e mundshme në njerëz dhe në të mira materiale:**

Pasojat e veprimit të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera në njerëz dhe në të mira materiale mund të jetë, varësisht prej, intensitetit, llojit dhe kohëzgjatjes së fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, që variojnë në një diapazon prej pasojave minimale deri tek pasojat të cilat rrezikojnë shëndetin dhe jetën e njerëzve dhe dëme të rënda në të mira materiale apo kulturore dhe të tjera. Pasojat e veprimit të fatkeqësive natyrore dhe të tjera mund të ketë një ndikim negativ në gjendjen e mjedisit, dhe mund të arrijë përkeqësimin e konsiderueshëm të gjendjes ekologjike dhe të mjedisit.

“Disa nga fatkeqësitë natyrore, si tërmetet, përmytjet, stuhi e fortë era, rrëshqitjet e tokës, zjarret, , aksidenteve të mëdha teknologjike, aksidenteve të mëdha të trafikut, sëmundjeve epidemike dhe të sëmundjeve të botës bimore dhe asaj shtazore në shkallë të gjerë, mund të të shkaktojë pasoja katastrofale në njerëz dhe në të mira materiale”.

(Burimi: këto të dhëna janë marrë nga Plani i Vlerësimit të Rreziqeve për Komunën e Malishevës dhe PZHK)

Paraqitja tabelare e Planit Vjetor të Punës për vitin 2022:

Nr	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	Bartësit e aktiviteteve	Rezultatet e pritura	Afati kohor	Burimet financiare
1	Bashkërendimi i iniciativave të përbashkëta të mekanizmave institucional për zgjidhjen e problemeve të sigurisë të çdo komuniteti	Hartimi i Planit Vjetor të punës së KKS-së	Anëtarët e KKS-së	- Ndermeren iniciativa të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve për siguri në Bashkësi	Janar-' 2021	Nuk ka implikime buxhetore
2	Senzibilizimi i qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitet si dhe identifikimi i brengave lidhur me sigurinë publike	Organizimi i takimeve me qytetar në këto lokalitete: Malishevë, Banjë, Bellanicë, Pagarushë, Carrallukë, Lumnishtë, Panorc, Kijevë, Astrazup, Drenoc dhe Lladroc	Anëtarët e KKS-së	-Rritet vetëdijësimi i qytetarëve për natyrën e krimeve, identifikohen brengat e qytetarëve për sigurinë publike	Janar-Gusht' 2022	300.00 € Buxheti Komun.
3	-Rritja e bashkëpunimit të mekanizmave insitucional nga lëmia e sigurisë publike	-Mbajtja e takimeve të rregullta ndërinsitucionale dhe nderkomunale:KKS-B-EVSB-KLSP, -Formimi i KLSP-ve, Takime me KKS të Komunave fqinje	Anëtarët e KKS-së, EVSB-së (KLSP)	-Shkembim përvojash nga fusha e sigurisë publike	Janar-Dhjetor' 2022	Buxheti Komun., Donac. 500.00 €
4	-Siguria në shkollat fillore dhe ato të mesme, -Siguria e nxënësve në trafik,	Patrollimi i rregulltë i Policisë, posaçërisht gjatë orarit të fillimit dhe mbarimit të orarit mësimor	Policia e Kosovës	Minimizimi i incidenteve	Janar-	Buxheti Komun., Donac.

	-Vendosja e videokamerave (në ato shkolla ku mungojnë)			mes nxënësve	Dhjetor' 2022	
5	Vendosja dhe funksionalizimi i videovezhgimit të hapsirave publike në qytezën dhe pkat e identifikuar të Malishevës	-Realizimi i projektit për vendosjen e videokamerave, (Faza e dytë e projektit)	DKMSH, Policia e Kosovës, AME-MPB	-Ngitja e Sigurisë së përgjithshme publike, -Funksionalizimi i QOKE- (Qendra Operative Komunale Emergjente)	Janar-Qershor ' 2022	Buxheti Komunal, MPB, Donacione
6	Senzibilizimi i të rinjëve për mbrojtje nga dukuritë negative që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre (rreziku nga përdorimi i narkotikëve), -Informimi i nxënësve për dhënien e ndihmës së parë, shuarjes së zjarrit, kerkim shpëtimit, etj.	Masat parandaluese dhe sensibilizimi i qytetarëve për pasojat nga zjarri-posaçërisht gjatë periudhës së korrjes-shirjeve. Bashkëpunimi me DBPZHR, SHPMSH, Agjencionin Pyjor Agjencionin e Menaxhimit Emergjent-për parandalimin e djegieve të pyjeve,aksionet e përbashkëta në shuarjen e zjarreve pyjore,etj. Mbjetja e ligjeratave në shkollat e Komunës së Malishevës	KKSB,DKA, DKSHMS, PK, Anëtarët e KKSB DSHPM SH DI APK AME Policia e Kosovës KKSB,DKA, DKSHMS, Kryqi i Kuq, Nj.K.D.Nj PK, FSK	Ngitja e vetëdijësimit nga rreziku i përdorimit të narkotikëve, dhënies së ndihmës së parë	Janar-Dhjetor' 2022	Buxheti Komun., Donac. 1000.00 €
	Parandalimi, mbrojtja dhe	Mbjetja e ligjeratave në shkollat e	KKSB,DKA, DKSHMS,	-Ngitja e vetëdijësimit nga rreziku i trafikimit me		

7	luftimi i trafikimit me qenie njerëzore, Parandalimi i dhunës në familje.	Komunës së Malishevës, Botimi i broshurave për sjellje në situata Emergjente	Kryqi i Kuq,QPS, Policia e Kosoves, Gjykata, Nj.K.D.Nj	qenie njerëzore, dhe ngitja e bashkëpunimit nderinstitucion a në luftimin e dhe parandalimin e dhunës në familje	Mars-Shtator' 2022	Buxheti Komun., Donac. 500.00 €
8	Organizimi dhe funksionimi i Këshillave në shkollat e komunës së Malishevës	Formimi i Këshillave të nxënësve në shkolla	KKSB, DKA, Nj.K.D.Nj	Ngritja e pjesmarrjes së të rinjëve në procesin e siguris publike dhe minimizimi i incidenteve mes tyre.	Janar-Dhjetor' 2022	Nuk ka implikim buxhetor
9	Siguria e të rinjëve në lokalet e nates, lojrave të fatit etj.	kontrollimi dhe patrullimi i lokaleve të natës, lojrave të fatit dhe monitorimi i zbatimit të orarit të punës së bizneseve	KKSB, Drejtoria Komunale e Inspektionit, Policia e Kosoves	Zbatimi i Rregulloreve Komunale për orin e punës së bizneseve etj.	Janar-Dhjetor' 2022	Nuk ka implikim buxhetor
10	Përdorimi dhe mbajtja ilegale e armëve dhe mjeteve piroteknike gjatë festave dhe ahengjeve	Mbajtja e ligjeratave, përgaditja edhe shpërndarja e broshurave, posterëve etj. Vetëdijesimi i nxënësve për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike . Vetëdijesimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjeteve të tjera të pa shperthyer .	KKSB - Policia e Kosoves-FSK	Ngitja e sigurisë së përgjithëshme publike, Zvogëlimi i rasteve të incidenteve gjatë festave dhe ahengjeve familjare	Janar-Dhjetor' 2022	500.00 € Buxheti Lokal dhe Qendror
	Siguria në Komunikacion (Patrullimi i	Vendosja e shenjave horizontale dhe	KKSB, EVSB, Ispektoriati,	Ngitja e sigurisë së përgjithëshme	Janar-	Buxheti Lokal

11	PK, shenjzimi dhe vendosja e treguesëve të komunikacionit), Rregullimi i trotuarëve nëpër vendbanime	vertikale në komunikacion Shenjzimi i vend parkingjeve për PAK Ndertimi i Tolaletëve për PAK	Nj.K.D.Nj, HANDIKOS, DSHP.	publike, Zvogëlimi i rasteve të incidenteve në komunikacion	Qershor '2022	dhe qendror
12	Parandalimi i prerjes së pakontrolluar të pyjeve, -Parandalimi i eksploatimit të rëres dhe zhavorit.	-Mbajtja e takimeve me qytetar për rëndësinë dhe mbrojtjen e pyjeve, -Përgaditja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve	KKSB, DKBPZHR, Drejtoria e Inspektoriatit	-Ngritja e vetëdijësimit të qytetarëve për kujdesin dhe mbrojtjen e pyjeve (natyrës).	Qershor - Dhjetor' 2022	Buxheti Lokal dhe Qendror
13	Rreziqet nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dhe Ambijenti	-Projektet për reagim ndaj ETHKK(Rapelimi i Kafshëve, Spërkatja e zonave endemike nga toka dhe ajri), -Zgjidhja e problemit të kafshëve të braktisura (qent endacak dhe macet), -Fushata sensibilizuese nga lëmia e shendetit publik, mbrojtjes nga zjarri. -Menaxhimi i mbeturinave(eliminimi i deponieve joformale). -Mbajtja e ligjeratave në shkolla mbi rëndësinë e marrjes së masave preventive -Pastrimi i deponive joformale të hudjes së mbeturinave. -Mbajtja e ligjeratave në shkollat e fillores dhe të mesme, përgaditja edhe shpërndarja e	DKMSH, DKBPZHR, Drejtoria e Inspektoriatit , DKSHMS, IKSHP, MBZHR Policia e Kosovës dhe FSK-ja	-Ngritja e sigurisë së shendetit të qytetarëve-minimizimi i rasteve të pickimit dhe viktimave. -Ngritja e nivelit tëvetëdijës së qytetarëve mbi rëndësinë e shendetit dhe mbrojtjen nga zjarri dhe rreziqe të tjera.	Janar – Dhjetor' 2022	1000.00 € Buxheti Lokal dhe Qendror, Donac.

		broshurave, posterëve etj.				
14	Rrespektimi i të drejtave të njeriut	- Rrespektimi mbi të drejtat e pakicave dhe PAK, - Bashkëpunimi me QPS, OQ dhe OJQ për përmirësimin e kushteve socio- ekonomike (njoftimi mbi të drejtat për asistencë sociale, pension invalidor etj. Dhe Ndertimi i i Tolaletëve për PAK	- Zyra Komunale për Komunitete, Zyra Komunale për Barazi Gjinore, QPS, Nj.K.D.Nj	Vetëdijësimi i pakicave dhe PAK mbi të drejtat e tyre.	Janar – Dhjetor' 2022	500.00 € Nuk ka implikime buxhetore
15	Kompenzimi	Pagesa e anëtarëve të KKSB-së konform Nenit 18. të UA Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		Qershor - Dhjetor 2022	5700.00 €
GJITHSEJ:						10,000.00 €